

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN

#### PËR MIRATIMIN E PLANIT AFATGJATË TË ZHVILLIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA 2024-2033

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033 (PAZHFA) është një nga dokumentet kryesore në fushën e mbrojtjes, është dokument themelor që jep parimet dhe konceptet kryesore për zhvillimin, përdorimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare Strategjinë Ushtarake dhe në Strategjinë Ushtarake të NATO-s.

PAZHFA 2024-2033 përcakton kapacitetet e FARSH që duhen ngritur, zhvilluar dhe mbajtur duke përkthyer kështu objektivat e Strategjisë Ushtarake në aftësi, në funksion të mbrojtjes kombëtare dhe asaj kolektive. Zhvillimi i kapaciteteve në fjalë parashikohet të arrihet sipas fushave të përgjegjesisë dhe afateve kohore.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033 është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Projektligji “Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033”, nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për Ministrinë e Mbrojtjes, për vitin 2024.

#### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Mjedisi i sigurisë ka pësuar ndryshime domethënëse, ku agresioni rus ndaj Ukrainës ka thyer normat dhe parimet e sovranitetit kombëtar të vendosura pas Luftës së Dytë Botërore dhe ka rikthyer luftën në Evropë. Nuk përjashtohet mundësia e një sulmi konvencional kundër vendeve aleate në NATO-s apo që kjo luftë të ketë efekt domino edhe në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, edhe në vijimësi të rishikimit të dokumenteve të tjera strategjike (SSK, SU) lind nevoja e rishikimit të kapaciteteve ushtarake të nevojshme për mbrojtjen e vendit, sigurimin e qëndrueshmërisë kombëtare, si dhe kapacitetet për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me rendin juridik të brendshëm. Ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 8 parashikon se *Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është autoriteti më i lartë në hierarkinë e pushteteve dhe autoriteteve të drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:*

*d) miraton, me propozim të Këshillit të Ministrave, planet afatgjata të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura ... .*

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Vizioni i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA për perspektivën e FA bazohet në objektivat e politikës dhe strategjisë së mbrojtjes për ndërtimin e një force të armatosur, të motivuar të përgatitur të mirëpaisur për realizimin e misionit kushtetues dhe përmbushjes së angazhimeve në kuadrin e sigurisë kolektive dhe më gjerë.

Në themel të PAZHFA 2024-2033 është zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme të FARSH në përmbushje të misionit të tyre kushtetues, detyrimeve në kuadër të Aleancës dhe marrjes pjesë në operacione të cilat zhvillohen në kuadër të BE, OKB.

Projektligji “Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033”, përbëhet nga 4 nene dhe nga Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033.

Në nenin 1, përcaktohet miratimi i Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij projektligji.

Në nenin 2 parashikon që ligji nr. 121/2015, “Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025”, shfuqizohet

Në nenin 3, ngarkohet Këshilli i Ministrave që të përgatisë aktet e nevojshme, sipas përcaktimeve të bëra në Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033.

Në nenin 4, parashikohet hyrja në fuqi e këtij akti.

PAZHFA 2024-2033 është një dokument i ndërtuar si më poshtë:

Kreu I: Të përgjithshme;

Keru II: Vlerësimi i mjedisit të sigurisë

Kreu III: Kuadri strategjik;  
Kreu IV: Kërkesat dhe drejtimit kryesore për FARSH-in  
Kreu V: Kapacitetet e ardhëshme të FA-së;  
Kreu VI: Kapacitetet e komunikim-komandim-kontrollit në FA;  
Kreu VII: Mbrojtja kibernetike.  
Kreu VIII: Operacionet  
Kreu IX: Burimet e Mbrojtjes  
Kreu X: Bashkëpunimi  
Kreu XI: Përfundime

**Kreu I** parashikon dispozita të përgjithshme. Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024-2033 (PAZHFA 2024-2033) përkthen objektivat e Strategjisë Ushtarake, në kapacitete ushtarake, duke tentuar plane orientuese në pikëpamje të kohës dhe burimeve të disponueshme.

Ky dokument përcakton drejtimit e zhvillimit të Forcave të Armatosura (FA) dhe orienton ngritjen, zhvillimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimeve në kuadër të mbrojtjes kolektive.

Me miratimin e PAZHFA 2024-2033, Komandat e Forcave (Tokësore, Detare, Ajrore), dhe ato mbështetëse do të hartojnë planet e tyre respektive mbështetëse për implementimin e këtij plani.

**Kreu II**, përbëhet nga mjedisi strategjik i sigurisë. Ky kapitull pasqyron analizën e faktorëve që ndikojnë në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë. Mjedisi i sigurisë ndahet në nivel global, rajonal dhe atë kombëtar, ku më pas trajtohen mundësitë dhe kërcënimet potenciale që rrjedhin prej tij. Këto kërcënime klasifikohen në konvencionale (kërcënimi rus) dhe jo konvencionale (si p.sh. terrorizmi, krimi i organizuar, korrupsioni, sulmet kibernetike fatkeqësitë natyrore dhe degradimi i mjedisit etj.).

**Kreu III** trajton ndikimin që ka mjedisi i sigurisë ndaj FARSH-it, duke evidentuar ndikimet e rreziqeve si zhvillimet ndërkombëtare, konsideratave rajonale, ndërveprimit të teknologjisë, dhe rrethanave të brendshme. FARSH kanë në mision të tyre të sigurojnë pavarësinë, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe rendin kushtetues të vendit në bashkëveprim me forcat aleate, mbrojtjen dhe mbështetjen e popullsisë e të autoriteteve civile në kohë paqeje, krize e lufte, të kontribuojnë për mbrojtjen kolektive, si dhe paqen e sigurinë në rajon e më gjerë.

**Kreu IV** trajton llojet e kapaciteteve brenda FA. Kapaciteti ushtarak gjenerohet nga kombinimi i elementëve themelorë të kapaciteteve të mbrojtjes të cilat kategorizohen në:

- një forcë ushtarake efektive e gatshme dhe e aftë (*e kompletuar, e përshtatshme, e ndërveprueshme*);
- zhvillimi, menaxhimi dhe motivimi i personelit;
- arsimimi, trajnimi dhe kualifikimi i personelit;
- zhvillimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë;
- zhvillimi i infrastrukturës ushtarake;
- mbështetja logjistike dhe kapacitetet e vendit pritës;
- bashkëpunimi ushtarak.

Kërkesat për zhvillimin e kapaciteteve të FARSH rrjedhin nga detyrimet e mëposhtme:

- Kombëtare
- Qëndrueshmëria
- Emergjencat Civile
- Në kuadër të NATO-s.
- Në kuadër të BE-së dhe OKB-së

Për plotësimin e këtyre kërkesave PAZHFA përcakton disa objektiva sipas këtyre drejtimeve kryesore:

- Zhvillimi, menaxhimi dhe motivimi i personelit.
- Arsimimi, trajnimi dhe kualifikimi i personelit.
- Zhvillimi i kapaciteteve.
- Projektet e zhvillimit të infrastrukturës ushtarake.
- Mbështetja logjistike.

**Kreu V** Për të arritur objektivat sipas drejtimeve kryesore të përmendura më lart, PAZHFA përcakton kapacitete e nevojshme për tu zhvilluar dhe mbajtur, sipas afateve kohore (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë), si dhe forcave dhe komandave. Fokusi në zhvillimin e kapaciteteve në 10 vitet e ardhshme sipas kapaciteteve do të jetë: Kapacitetet e Luftimit, të mbështetjes të luftimit dhe atyre të mbështetjes më shërbime të luftimit. Ndërsa kapacitetet sipas fushës së përgjegjësisë do të zhvillohen të ndara në forcën tokësore, detare, ajrore, si dhe ato mbështetëse, duke i kushtuar hapësire edhe arsimimit, stërvitjes dhe trajnimit në FARSH.

**Kreu VI** kapacitetet e Komunikim-Komandim-Kontrollit në FA:

Fokusi i zhvillimit të kapaciteteve për komandim-kontrollin do të jenë kërkesat e objektivave të kapaciteteve të NATO-s, si dhe trendi i teknologjisë të së ardhmes në komunikim-komandim-kontroll me sisteme dhe programe kompjuterike, të cilat do të rritin efektivitetin e forcave të luftimit, duke krijuar rrjetin taktik të informacionit, zbatimin e sistemit të gjurmimit të forcave tona dhe modernizimin e vendkomandave. Këto kapacitete do të sigurohen nëpërmjet kompletimit dhe futjes në përdorim të sistemeve dhe programeve të posaçme, të cilat rekomandojnë zgjidhjet optimale në situata të ndryshme, duke shfrytëzuar inteligjencën artificiale, programet për zbulimin, mbrojtjen kibernetike, programet për komunikimin taktik dhe sistemet e përbashkëta të radiove taktike etj.

**Kreu VII, Mbrojtja Kibernetike:**

Kapacitetet operacionale të sigurisë kibernetike kanë për qëllim të sigurojnë Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI) të FARSH-it nga sulmet kibernetike, sigurimin e një hapësire kibernetike të sigurt, fleksibël e të besueshme që mbështet sigurinë e këtyre sistemeve të konsolidimit të aftësive mbrojtëse e kundërvepruese, rritjes së vetëdijes, profesionalizmit dhe fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këto kapacitete do të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, duke mbajtur ritmin me kërcënimet dhe mjedisin e teknologjisë që ndryshon me shpejtësi, të arrijnë kapacitete operacionale të afta për mbështetjen e komandim kontrollit në FARSH, me qëllim realizimin e misionit të tyre, si brenda dhe jashtë vendit në kuadër të misioneve të drejtuara nga NATO-ja, duke arritur nivelin e ndërveprueshmërisë dhe të sigurisë së mbrojtjes kibernetike, në përputhje me politikat dhe standardet e NATO-s për sistemet e komunikimit dhe informacionit.

### **Kreu VIII, Operacionet:**

Zhvillimi i kapaciteteve të përmendura në këtë plan do të mundësojnë që FARSH-i të jetë plotësisht e ndërveprueshme dhe të japë kontribut cilësor në operacionet brenda dhe jashtë vendit të drejtuara nga NATO-ja, por edhe nga BE-ja apo OKB-ja.

### **Kreu IX, Burimet e Mbrojtjes,**

Burimet e mbrojtjes të cilat përfshijnë të gjitha asetet njerëzore, materiale dhe financiare, në dispozicion të FA-së për të realizuar misionin dhe detyrimet në kuadrin e mbrojtjes kolektive. Një theks të veçantë i jepet mbështetjes me buxhet mbrojtës të FARSH në nivelet jo më pak se 2% të PBB.

Planifikimi i burimeve të mbrojtjes do të krijojë kushtet për shfrytëzimin me efikasitet të tyre sipas Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH (PAZH), me qëllim zhvillimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të kërkuara. Këto burime kategorizohen në: Burimet njerëzore, Burimet financiare, Burimet material, Infrastruktura, Kapacitetet logjistike.

**Kreu X, bashkëpunimi,** Bashkëpunimi ushtarak mbetet i fokusuar në bashkëpunimin me aleatët strategjikë dhe NATO-n. Ky bashkëpunim pritet të intensifikohet në të ardhmen dhe do të jetë i orientuar në arsimim, trajnim, stërvitje dhe modernizim. Forcat e Armatosura do të jenë pjesë e iniciativave dhe strukturave të përbashkëta rajonale dhe do të marrin pjesë në operacione të përbashkëta. Nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak rajonal synohet gjithashtu nxitjen e krijimit dhe përdorimit të kapaciteteve të përbashkëta ushtarake, kryesisht kapacitete për përballimin e emergjencave civile, por edhe krijimin dhe përdorimin e kapaciteteve në kuadër të operacioneve të NATO-s.

**Kreu XI, Përfundimet,** Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA 2024 – 2033 do të shërbejë si udhëzim dhe do të sigurojë kuadrin e përgjithshëm për zhvillimin e strukturës së forcës dhe zhvillimin e kapaciteteve ushtarake të nevojshme për përballimin e sfidave të sigurisë aktuale dhe të ardhshme.

Zbatimi i këtij PAZH-i do të krijojë një Forcë të Armatosur të mirëpajisur dhe mirëtrajnuar, e aftë për të mbrojtur hapësirën kombëtare dhe interesat e Shqipërisë dhe për të mbështetur mbrojtjen kolektive në hapësirën e Aleancës

Zhvillimi dhe arritja e plotë e kapaciteteve sipas këtij plani ndikon drejtpërdrejt në rritjen e garantimit të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë, bazuar së pari në forcat dhe mundësitë kombëtare e më pas në bashkëpunim me Aleatët. Kapacitete që do të synohen të zhvillohen me hartimin e PAZH-it të radhës, siç janë identifikuar gjatë vlerësimit dhe fizibilitetit, janë të tilla, si sistemet dhe platformat e lëshimit të raketave me një rreze të largët dhe avionë luftarakë.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA do të jenë institucionet kryesore për zbatimin e saj. Ministria e Mbrojtjes do të bashkëpunojë ngushtë në zbatimin e detyrimeve të kësaj strategjie me ministrinë e tjera të linjës, Kuvendin, Presidentin e Republikës, Këshillin e Ministrave.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Hartimi i PAZHFA është bazuar në ekspertizën më të mirë, duke përfshirë në grupin e punës për hartimin e tij komandantë, oficerë shtabi, ushtarakë pjesëmarrës në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, stafe akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, konsulencën e aleatëve strategjikë.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë së Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Burimet financiare për mbështetjen e shpenzimeve të mbrojtjes sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit për mbrojtjen dhe nga programet e bashkëpunimit ushtarak.

Tabela A.a shpreh parashikimin e buxhetit të Mbrojtjes për vitet 2024-2033. Tabela A.b nga ana tjetër paraqet koston e përafërt të PAZHFA-së, për periudhën 2024-2033 për çdo vit dhe në total. Në të shprehet qartë nevoja në rritje e FARSH-it për buxhet, me qëllim ndërtimin, zhvillimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të nevojshme dhe të kërkuara, nevojë kjo që mesatarisht i afrohet vlerës 2,08% të PBB, pra nevoja për buxhet tejkalon nivelin dysheme të buxhetit të Mbrojtjes, marrë si angazhim nga Republika e Shqipërisë.

Për sa i përket investimeve me dy kategoritë kryesore të investimeve nw modernizim dhe investime në infrastrukturë, Tabela C paraqet sipas afateve kohore koston e planifikuar për investimet në modernizim dhe infrastrukturë.

### **Parashikimi i Buxhetit të Mbrojtjes nga MM për vitet 2024-2033**



Në milion lekë

Tabela A.a Parashikimi I buxhetit te mbrojtjes 2024-2033 sipas kategorive										
Kategoria/vitet	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033
Personeli	19,474	20,722	21,739	22,721	23,746	24,817	25,936	27,104	28,324	29,457
Oper. & M.	14,606	15,541	16,305	17,041	17,810	18,613	19,452	20,328	21,243	22,093
Investime	14,606	15,541	16,305	17,041	17,810	18,613	19,452	20,328	21,243	22,093
<b>Total</b>	<b>48,686</b>	<b>51,804</b>	<b>54,349</b>	<b>56,803</b>	<b>59,366</b>	<b>62,043</b>	<b>64,840</b>	<b>67,760</b>	<b>70,810</b>	<b>73,643</b>

Tabela A.b Parashikimi I buxhetit te mbrojtjes 2024-2033 ne perqindje te PBB										
Vitet	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033
PBB/milion leke	2,434,311	2,577,410	2,690,517	2,798,138	2,910,063	3,026,466	3,147,524	3,273,425	3,404,362	3,540,537
<b>PAZH</b>	<b>48,686</b>	<b>51,806</b>	<b>54,349</b>	<b>56,803</b>	<b>59,366</b>	<b>62,043</b>	<b>64,840</b>	<b>67,760</b>	<b>70,810</b>	<b>73,643</b>
<b>PAZH/%PBB</b>	<b>2.00</b>	<b>2.01</b>	<b>2.02</b>	<b>2.03</b>	<b>2.04</b>	<b>2.05</b>	<b>2.06</b>	<b>2.07</b>	<b>2.08</b>	<b>2.08</b>

PBB- Prodhimi i Brendshëm Bruto (sipas vendimit Nr.41, datë 24.1.2024 "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2025 – 2027).

BM- Buxheti i Mbrojtjes që i është dhënë ose parashikohet t'i jepet MM nga Këshilli i Ministrave sipas tavaneve buxhetore.

TABELA C INVESTIMET PËR MODERNIZIMIN E SISTEMEVE DHE PAJISJEVE PËR PERIUDHËN 2024 - 2033										
VITET (PERIUDHAT) E PLANIFIKIMIT	Periudhat	Vitet	Modernizim/Infrastrukturë	STRUKTURA						Totali i Parashikuar
				Forca Tokësore	Forca Detare	Forca Ajrore	Komanda Mbështetëse	AFA	Struktura të tjera të FA	
				Leke	Leke	Leke	Leke	Leke	Leke	
				Leke	Leke	Leke	Leke	Leke	Leke	
	PERIUDHA AFAT - SHKURTËR	2024-2026	Modernizim	8,960,090	10,108,000	17,616,991	3,513,780	174,777	1,954,922	42,328,560
			Infrastrukture	4,127,127	8,551,000	4,254,373	2,433,381	1,323,900	474,499	21,164,280
	PERIUDHA AFAT-MESME	2027-2030	Modernizim	9,374,383	6,627,500	16,762,600	3,484,100	6,000	994,787	37,249,370
			Infrastrukture	3,467,668	7,972,430	5,119,279	896,503	791,300	377,500	18,624,680
	PERIUDHA AFAT-GJATË	2031-2033	Modernizim	6,250,000	6,260,000	26,258,694	2,943,845	-	730,261	42,442,800
			Infrastrukture	3,600,000	9,821,400	5,000,000	1,700,000	700,000	400,000	21,221,400
Totali	2024-2033	Modernizim	24,584,473	22,995,500	60,638,285	9,941,725	180,777	3,679,970	122,020,730	
	2024-2033	Infrastrukture	11,194,795	26,344,830	14,373,652	5,029,884	2,815,200	1,251,999	61,010,360	

Shtirja e programeve në vite, do të reflektohet në varësi të mbështetjes financiare për FA, duke mbajtur në konsideratë prioritetet e përcaktuara nga Ministria e Mbrojtjes.

MINISTRI

Niko Peleshi